



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

SYLLABUS i lëndës:

Menaxhimi i dijes

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Biznesit
Titulli i lëndës:	Menaxhimi i dijes dhe transformimi digjital
Niveli:	MA
Statusi i lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	II (semestri IV)
Numri i orëve në javë:	3
Vleranëkredi – ECTS:	5
Koha / lokacioni:	FB
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Ass. Dr. Vlora Berisha
Detajet kontaktuese:	e-mail: vlora.berisha@unhz.eu
Përshkrimi i lëndës	Ky kurs fokusohet në lidhjen midis Menaxhimit të dijes dhe Transformimit Digjital, duke ofruar një kuptim të plotë për studentët rreth mënyrës se si kapitali intelektual mund të përdoret në mënyrë strategjike brenda ndërmarrjeve. Përmes shqyrtimit të teorive, modeleve, dhe mjeteve digjitale, studentët do të zhvillojnë aftësitë e nevojshme për të udhëhequr suksesin organizativ në mjedisin biznesor që ndryshon vazhdimisht.
Qëllimet e lëndës:	Qëllim i lëndës është që t'i pajisë studentët me njohuri të mjaftueshme, që ata: -- t'i njohin konceptet themelore të dijes dhe pikëpamjet e ndryshme të njohurive; - t'i njohin metodat e ndryshme të menaxhimit të dijes; - t'i kuptojnë teknikat themelore për menaxhimin e dijes;

	- t'i njohin dhe zbatojnë llojet e ndryshme të mjeteve digjitale për përkrahjen e dijes në organizatë; - ta kuptojnë arkitekturën dhe zhvillimin e sistemeve të dijes; - t'i menaxhojnë proceset e zhvillimit të BNJ në organizatë; - të ripërtërijnë vazhdimisht njohuritë e tyre dhe t'i shpërndajnë ato në organizatë dhe jashtë saj; - të përfitojnë shkathtësi të mjaftueshme për t'i njohur dhe zhvilluar këto procese në organizate.
Rezultatet e pritura të nxënies:	Nëpërmjet kësaj lënde studentët do të aftësohen që: - t'i përdorin kornizë dhe gjuhë të qartë për konceptet e menaxhimit të dijes; • të dinë sesi menaxhohen njohuritë e vlefshme individuale, grupore dhe organizative gjatë gjithë ciklit të menaxhimit të dijes; • t'i përcaktojnë llojet e ndryshme të dijes dhe të mund të shpjegojnë se si adresohen ato; • t'i përshkruajnë rolet dhe përgjegjësitë kryesore në menaxhimin e dijes • t'i identifikojnë disa nga mjetet dhe teknikat kryesore të përdorura në menaxhimin e dijes; • t'i identifikojnë dhe vlerësojnë çështjet kryesore të menaxhimit të dijes, siç janë: etika, pronësia e dijes; autorësia, e drejta e autorit, pronësia intelektuale etj. - t'i modelojnë njohuritë e tyre brenda rregullave të vendimmarrjes; - ta jetësojnë meta-interpretimin e tyre mbi bazën e dijeve dhe njohurive të cilat i ka organizata; - t'i përcaktojnë qartë qëllimin dhe mënyrën e funksionimit të sistemit të dijes; - të mund t'i diskutojnë përfitimet e organizatës nga zbatimi i metodave dhe i teknikave për menaxhimin e dijes; - Të përfitojnë shkathtësi për mënyrën e organizimit të njerëzve dhe të dijes, si pjesë e organizimit në ndërmarrje. Kjo, ndonjëherë, është më e rëndësishme për inovacionet sesa të kesh dituri mbi principet shkencore. - T'i përvetësojnë shkathtësitë e nevojshme për t'i bërë gjërat mirë në praktikë.

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjëqëduhettëkorrespondoj me rezultatet e tënxënittëstudentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjerata, Kolokium	3	15	45
Ushtrime teorike/laboratorike	0	0	0
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	2	7	14
Detyra shtëpie	1	16	16
Seminare, projekte, prezantimet,etj.	1	10	10
Koha e studimit vetanë të Studentit	1	15	15
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	1	5	5
Përgatitja përfundimtare për provim	5	4	20
Totali			125
Metodologjia e mësimdhënies:	Lënda do të zhvillohet në tri orë ligjërata në javë dhe dy orë ushtrime. Gjatë ligjëratave do të shtjellohet materiali mësimor dhe do të kërkohet diskutim interaktiv. Studentëve do t’u kërkohet që të bëjnë <i>lexime paraprake</i> (kapituj librash, artikuj shkencorë..., të ofruar nga mësimdhënësi). Gjatë ushtrimeve, materiali i shtjelluar në ligjërata do të rishikohet nga pikëpamja praktike. Do të shqyrtohen raste të ndryshme studimore, çështje aktuale dhe do të organizohen biseda grupore.		
Metodat e vlerësimit:	• Pjesëmarrje aktive - 5% • Testi I 0 – 15% • Testi II 0 –15% • Provimi përfundimtar 0-50% • Pjesëmarrja në ushtrime 0 - 5% • Punë grupore dhe raste studimi 0-10%		
Prezantimi	Prezantimet e studentëve (mund të duhet të bëhen edhe në javën e 14-të në varësi të madhësisë së klasës).		
Metodologjia e mësimdhënies	Një kombinim i leksioneve, lektorëve të ftuar, diskutimeve në grupe, videove, transmetimeve në internet, ushtrimeve në klasë dhe demonstrimeve do të përdoren në këtë kurs.		
Literatura			

Literatura bazë:	1. Dalkir, K. <i>Knowledge Management in Theory and Practice</i>. Second Edition. Boston, MA: MIT Press. 2. Becerra-Fernandez Rajiv Sabherwal. Knowledge management : systems and processes / Second edition. 2015 Taylor & Francis ISBN: 978-1-315-71511-7 (ebk) 3. Ymer Havolli, ligjeratë e autorizur. <i>Mexhimi i dijes</i>; 4. Danvport T., Prusak L.: <i>Working knowledge: How organizations manage what they know</i>, Harvard Bussiness Scholl Press, 2000.
Literatura shitesë:	1. Garvey B., Williamson B.: <i>Beyond knowledge management</i>, Pearson education, London, 2002. 2. Malhatra Y.: <i>Knowledge management for e-business performance – Advancing information strategy to internet time</i>, The Executive Journal, Vol.16, 2000. 3. Nonaka I, Takeuchi H.: <i>The knowledge-creating company: How Japanese companies create the dynamics of innovation</i>, Oxford University Press, New York, Digital Transformation Success- Michael Schank.2022 4. Sylqa, D., & Neziraj, E. (2022). The Relation Between Organizational Learning and Information Technology in Companies with International Activities During the Covid-19 Pandemic. <i>Calitatea</i>, 23(186), 279-286.
Plani i dizejnuar i mësimit:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Java e parë:	Hyrje në menaxhimin e dijes: Historia e shkurtër e menaxhimit të dijeve (MD), çfarë është MD; konceptet themelore, teknika e analizës, rrënjët multidisiplinare të MD, dy format kryesore të dijes, e heshtur dhe e qartë, rëndësia e MD për individët, dhe organizatat; rolet dhe përgjegjësitë e reja të MD; ndikimi në sukses.

Java e dytë:	Cikli i menaxhimit të dijes: Përshkrimi i lëndës kryesore; fazat e përfshira në ciklin e menaxhimit të dijes: kapja, krijimi, kodifikimi, ndarja, hyrja, aplikimi dhe ripërdorimi i njohurive brenda organizatave. Katër qasje kryesore; sintezë e qasjeve kryesore; informacioni si aset i vlefshëm i njohurive në organizatë.
Java e tretë:	Modelet e menaxhimit të dijes: Menaxhimi i të dijes si iniciativë që do të ketë sukses; Aktivitetet kryesore të MD; korniza konceptuale për të funksionuar; modelet e menaxhimit të dijes; këndvështrimet e ndryshme; elementet konceptuale që formojnë infrastrukturën e MD.
Java e katërt:	Kuptimi i menaxhimit të dijes: Cikli i menaxhimit të dijes, kapja dhe / ose krijimi i dijes; qasjet, teknikat dhe mjetet e përdorura për të nxjerrë njohuri të heshtura, për të shkaktuar krijimin e njohurive të reja dhe për të organizuar më pas këtë përmbajtje në mënyrë sistematike (kodifikimi); teknikat e përdorura për zhvillimin e sistemeve të mbështetjes së performancës dhe qasjet taksonomike që burojnë nga sistemet e informacionit.
Java e pestë:	Dimensionet e menaxhimit të dijes: Bartja e njohurive; natyra e dijes, grupet për ndarjen e njohurive, evoluimi i tyre në organizata, zhvillimi i kapitalit shoqëror; teknikat dhe teknologjitë, rrjetet sociale; mjetet e vizualizimit dhe analizimi i rrjedhave të dijes, pengesat për ndarjen e njohurive.
Java e gjashtë:	Testi i parë me shkrim
Java e shtatë:	Transformimi digjital dhe Menaxhimi i rrjedhës së dijes (Zbatimi i dijes): Njohuritë e dobishme për cilën grup njerëzish; vënia në dispozicion e tyre; të kuptuarit e përdorimit të tyre, përmirësimi i kulturës organizative dhe i performancës; përdorimi i taksonomive të të mësuarit, sistemet e mbështetjes dhe teknikat e personalizimit ose profilizimit; gjetja dhe zbatimi i dijes; sistemet e menaxhimit; aplikimi i dijes mbi bazën e të dhënave.
Java e tetë:	Roli i kulturës organizative: Llojet e ndryshme të kulturave organizative; mikrokulturat e ndryshme në organizata; mundësuesit kulturorë dhe pengesat për ndarjen e dijes; organizimi i dëshiruar; ndryshimet për të akomoduar më mirë menaxhimin e dijes; dimensionet e kulturës organizative; modelet kryesore organizative; kujtesa organizative dhe të mësuarit organizativ; memoria organizative; modelet e kujtesës organizative dhe qasja në tri nivele (individuale, grupore dhe organizative) shmangia e humbjes së dijes ose "amnezia organizative".
Java e nëntë:	Strategjitë e menaxhimit të dijes (Krijimi i kapitalit intelektual) Hapat kryesorë të përfshirë në zhvillimin e një MD; hapat strategjikë; inovacioni; kreativiteti i balancuar me strukturën organizative; roli i individit.

Java e dhjetë:	Mjetet për menaxhimin e dijes: Pasqyrë e mjeteve të MD; “kutitë e zeza”; menaxhimi i dijes; përdorimi i teknologjisë; komunikimi, bashkëpunimi dhe menaxhimi; nxënia, bartja, shpërndarja dhe zbatimi i dijes. Roli i transformimit digjital- shqyrtimi i mjeteve (AI, IoT, blockchain)
Javae njëmbëdhjetë:	Krijimi i ekipeve: Ekipi për menaxhimin e dijes: përmbledhje e profesionistëve të cilët formojnë ekipin e MD; zbatimi i përgjegjësive; llojet e ndryshme të vendeve të punës – MD; zhvillimi profesional dhe çështjet etike.
Java e dymbëdhjetë:	“Ekonomia e dijes” Dituria si shtyllë qendrore për zhvillimin ekonomik; Transferi i diturisë; Transferi i brendshëm dhe ai i jashtëm i dijes.
Java e trembëdhjetë:	Testi i II-të me shkrim
Java e katërbëdhjetë:	Sfidat e ardhshme për menaxhimin e dijes: Çështjet politike në lidhje me motorët e kërkimit në internet, kalimi në asete të bazuara në njohuri; stimulimi për ndarjen e dijes etj.
Java e pesëmbëdhjetë:	Prezantimet e studentëve
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:	
- Para së gjithash, studenti duhet të jetë i ndërgjegjshëm dhe të respektojë institucionin dhe rregullatshkollore; - Duhet ta respektojë orarin e ligjëratave, ushtrimeve dhe të jetë i vëmendshëm në orën mësimore; - Studentët janë të detyruar që ta kenë kartelën e studentit (ID- në) dhe ta paraqesin atë në teste dhe në provim; - Gjatë hartimit të punimeve seminarike, studenti duhet t’u përmbahet udhëzimeve të dhëna nga mësindhënësi për realizimin hulumtues dhe teknik të punimit.	